



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 96
Prishtinë, më 24.12.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili
Ganimete Musliu, Anton Quni, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Mungoi: Vjollca Krasniqi

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Dhurata Kryeziu-OSBE, Ramadan Islami-GIZ, Luanda
Domi- DCAF, Venera Gashi-praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antingona
Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim- amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-
230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;**
3. **Të ndryshme;**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim- amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;

Kryetari- Theksoi se nga ana e grupit punues për projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, janë ofruar amendamentet, ndërsa si anëtar të Komisionit duhet të angazhohemi dhe këto amendamente t'i dërgojmë në seancë plenare. Tutje fjalën ia kaloi z. Fatmir Xhelili, kryesues i grupit punues.

Fatmir Xhelili- Fillimisht propozoi që në mbledhjen e radhës nga ana e Komisionit të bëhen disa rekomandime drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme për rumbullakimin e sistemit që quhet Menaxhimi i Integruar i Emergjencave, dokument ky i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili është dokument bazik në bazë të cilit organizohen dhe bashkë afrohen veprimet në rastin e gjendjes së emergjencave dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që kyçen në menaxhimin e emergjencave civile.

Bazuar në dokumentet dhe planin e reagimit që janë dokumente strategjike të miratuara nga Qeveria, kanë rrjedhur ligjet dhe harmonizimi i ligjeve që mbulojnë organizimin e njësive të zjarrfikësve të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, Policisë së Kosovës dhe FSK-së.

Gjatë hartimit të ligjeve që rregullojnë këtë fushë, për shkak të mungesës së konceptit të përgjithshëm, marrë parasysh faktorët ekzistues, në secilin prej këtyre ligjeve janë bërë disa lëshime që do të paraqesin pengesa gjatë menaxhimit të emergjencave, në situatat kur ngritët niveli i menaxhimit nga niveli 1 në 2,3 dhe 4.

Ndërsa sa i përket amendamenteve të propozuara për Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent tha se me këto plotësime ky projektligj plotëson kriteret që Agjencia për Menaxhimin Emergjencave të jetë e mirë strukturuar dhe të funksionoj në kushte dhe rrethana të ndryshme dhe për ti ndarë përgjegjësitë prej niveleve të pushteteve lokale.

Ndërsa propozimin lidhur me rekomandimet nga ana e Komisionit për përkufizimin e sistemit të Menaxhimit të Integruar të Emergjencave, nga ana e Komisionit bëhet ky rekomandim ndërsa nga anë e Ministrisë së Punëve të Brendshme të formohet grupi punues për të bërë harmonizimin e të gjitha ligjeve që të mos kenë kolizion dhe kjo do ta rregullonte statusin e zjarrfikësve dhe mënyrën veprimi të tyre në rrethana dhe situata të ndryshme.

Tutje shtoi se katërmbëdhjetë amendamentet e propozuara janë trajtuar nga ana e grupit punues bashkë me përfaqësuesit e MPB-së. Plotësimet janë më shumë të natyrës teknike me përjashtim të disa amendamenteve që janë thelbësore.

Në fund falënderoi anëtarët e grupit punues për angazhimin e tyre, duke shpresuar që ky projektligj do ti mundësoj Agjencisë për menaxhimin e emergjencave të funksionoj në rrethana të pa parashikuara, bazuar në dokumentin e vlerësimit të situatave dhe rreziqeve që mund ti kanosen vendit, nga faktorët natyrorë dhe faktori njeri.

Kryetari- tha se përkrah propozimin e z. Fatmir Xhelili, që në mbledhjen e radhës së Komisionit ti rekomandojmë Ministrisë së Punëve të Brendshme, që strategjitë që rregullojnë fushën e emergjencave, ligjet dhe dokumentet e tjera të harmonizohen, në mënyrë që sistemi emergjent të jetë funksional. Ndërsa lidhur me amendamentet e propozuara për Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent tha se janë paraqitur me kohë, secili anëtar mund të paraqes vërejtje dhe plotësime. Ndërsa përkrah amendamentet e propozuara, pasi janë një përpunim i mirë dhe bazik i ligjit.

Rexhep Selimi- Përkrah amendamentet e propozuara, pasi ky projektligj është hallkë e rëndësishme por jo e vetme për rregullimin e sistemit të menaxhimit të emergjencave. Amendamentet e propozuara janë më shumë të natyrës teknike, me përjashtim të disa amendamenteve që janë thelbësore. Si grup punues kemi bërë punën më të mirë të mundshme dhe se amendamentet e propozuara do të përkrahim në seancë si grup parlamentar.

Goran Marinkovic- Pajtohem me amendamentet e propozuara dhe mendoj që grupi punues ka bërë një punë të mirë. Gjithashtu duhet të theksoj se për versionin në gjuhën serbe të këtij projektligji partia “*E ardhmja e përbashkët për Kosovën*” ka dhënë vërejtjen e vet në lidhje me përkthimin në gjuhën serbe që i është bërë projektligjit, andaj shpresoj që teksti në gjuhën serbe do të rregullohet teknikisht.

Kryetari- Duke marrë parasysh që me përkthime po kemi probleme, e rëndësishme është që përmbajtja të mos ndryshohet

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni miratoi propozim amendamentet e grupit punës për Projektligjin nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe amendamentet e propozuara ju dërgohen komisioneve të përhershme për shqyrtim nga fushëveprimi i tyre.

3. Të ndryshme.

Kryetari- Njoftoi se Kryesia e Kuvendit e ka miratuar projektligjin për Komisionarin e Kuvendit të Kosovës për PK-në dhe FSK-në dhe më pas ky projektligj do të dërgohet në Qeveri, ku në një afat prej një muaj sipas rregullores së punës, ata do të kthejnë përgjigjeje. Falënderoi anëtarët e Komisionit për angazhimin e tyre në këtë projektligj si dhe partnerët si GIZ, OSBE dhe DCAF, po ashtu falënderoi z. Reinhold Robbe, ish Komisionarin gjerman për Forcat e Armatosura, i cili

e ka mbështetur nga fillimi këtë projekt. Në mbyllje falënderoi anëtarët e Komisionit për bashkëpunimin për këtë vit kalendarik.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi